

SHIFRA E NXËNËSIT

PROVIMI I MATURËS

GUSHT 2019

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

U D H Ë Z I M

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i mjeteve elektronike.

Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Testi DUHET të shkruhet LEXUESHËM me laps kimik. Nxënësi/nxënësja mund të shkruaj me shkronja dore ose shtypi. Nëse shkruan me shkronja shtypi DUHET të theksojë shkronjën e madhe.

Testi përmban detyra të cilat zgjidhen në njëren prej mënyrave në vazhdim:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë. Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes të përshkruash përgjigjet tua.

Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:

- është e pasaktë
- përgjigjja në detyrë me zgjedhje të shumëfishtë **NUK** është bart në fletën e përgjigjeve
- është rrethuar ose shkruar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë
- përgjigjja/eseja është e palexueshme dhe e paqartë
- përgjigjja/eseja është shkruar me laps të thjeshtë
- eseja **NUK** është shkruar në vendin e paraparë, por vetëm në faqet e parapara për koncept (shkrimi i konceptit nuk është i detyrueshëm)

Nëse gabon, vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe detyrën zgjidhe përsëri. Kur ta përfundosh punën, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tua.

Me fat!



* A 9 8 9 9 6 *

FAQE E ZBRAZËT

Paraglajdingu

Paraglajdingu është një nga sportet ajrore. Ky është një sport garues dhe rekreativ. Gjithashtu, bën pjesë në sportet ekstreme.

Fluturimi i lirë me parashutë (velë) është një nga sportet më të reja ajrore dhe një nga mënyrat më të lehta dhe më të thjeshta që të realizohet ëndrra e fluturimit. Ky sport zhvillohet dhe përhapet në mënyrë intensive gjatë pesëmbëdhjetë vjetëve të fundit dhe merr hov gjithnjë e më shumë në sporte ajrore. Arsyeja kryesore është se ky sport nuk kërkon mjete të mëdha financiare. Kjo është një qasje e lehtë dhe e shpejtë e fluturimit të pavarur, por edhe një rrezik i madh. Fluturimi pa një përgatitje cilësore teorike dhe trajnim praktik është një shans i madh për fatkeqësi. Për shkak të shpejtësisë së vogël të fluturimit, çdo ndryshim i shpejtësisë së erës dhe turbulenca, mund të rrezikojnë sigurinë. Prandaj trajnimi afatgjatë dhe sistematik është e vetmja mënyrë që të përjetohet kënaqësia në lundrimin me parashutë.

Pajisja për fluturim nënkupton: parashutën e fluturimit me velë (krahun), ulësen dhe sistemin e lidhjes, parashutën rezervë, kapelën mbrojtëse, këpucët mbrojtëse, dorëzat dhe veshjet, pajisjen për ndërlidhje dhe navigim.

Krahu është një parashutë drejtuese që ka një formë të zgjatur-elipse. Është i përbërë nga shtresa e epërme dhe e poshtme e materialit të hollë të papërshkueshëm, midis të cilit ndodhet një hapësirë e ndarë në dhoma. Krahu është i bërë prej materialit përshkueshmëria gazore e të cilit duhet të jetë sa më e vogël. Përshkueshmëria matet me porozimetër. Rrezet e diellit UV ndikojnë dëmshëm në materialin e krahëve dhe për këtë arsye ai ka një jetëgjatësi prej 200 deri në 300 orë. Pas kësaj kohe poroziteti rritet, ngarkesa dhe shpejtësia zvogëlohen dhe rreziku nga rrënimi i formës së drejtë rritet, presioni në dhoma në mes të shtresës së epërme dhe të poshtme zvogëlohet, ashtu që rreziku i fluturimit në krahët e vjetër rritet. Krahët e tillë të vjetruar zakonisht përdoren për ushtrime në livadh dhe në ndonjë shpat të vogël, pa kushte për fluturim.

Sistemi i lidhjeve përdoret për vendosjen e pilotit. Parashuta rezervë shërben për shpëtim të pilotit kur është në rrezik. Pajisjet mbrojtëse përdoren për mbrojtje të pilotit nga goditjet, të ftohtit, era dhe rrezatimit nga rrezet UV. Piloti duhet të jetë i furnizuar mirë për çdo fluturim sepse ai mund të zgjasë edhe disa orë. Në pajisje për ndërlidhje dhe navigim bëjnë pjesë radiostacioni portativ i dorës i cili shërben për vendosjen e lidhjes me udhëheqësin e fluturimit, pilotë të tjerë dhe ai bën pjesë në pajisjen përbërëse pa të cilën nuk fluturohet. Pajisjet shpesh janë mjete për matjen e lartësisë (variometri) që është i përshtatur posaçërisht për fluturuesit e paraglajderëve dhe sistemi global i pozicionit GPS gjithashtu i përshtatur për aplikim

në këtë mjet fluturues. Të gjithë njerëzit kanë frikë nga lartësia, që është e natyrshme sikurse çdo frikë nga e panjohura. Nëse dikush thotë se askurrë nuk ka pasur frikë gjatë fluturimit, nuk flet të vërtetën. Pilotët me përvojë përjetojnë frikë gjatë fluturimit kur kushtet për fluturim nuk janë të volitshme. Në fillim frika është shumë më e fuqishme dhe intensive, por me kohë me rritjen e shkathtësive, frika zvogëlohet, kurse kënaqësia në bukurinë e fluturimit të lirshëm rritet. Dëshira për fluturim është gjithmonë më e fuqishme se frika. Frika është mik i madh i çdo piloti sepse e pengon atë që t'i shtyjë kufijtë e fluturimit jashtë mundësive të çastit dhe aftësive.

Në këtë sport nuk hidhesh nga aeroplani siç mendohet shpesh. Pajisja e nevojshme paketohet lehtë në një trastë të shpinës (që ka një peshë prej 15 kg) dhe nevojitet një formë e transportit deri te mali më i përshtatshëm i afërt... Kur të gjendet lokacioni i përshtatshëm, nevojiten më pak se dhjetë minuta për përgatitje. Pas disa hapash të marrjes hov për fluturim përgjatë shpatit të malit dhe me rrymat e përshtatshme të rrymës së ajrit mund të fluturohet menjëherë. Përparësia e këtij sporti është se nuk ka nevojë për aeroporte ose për çfarëdolloj infrastrukture tjetër të shtrenjtë. Drejtuesi i veles vendos ku dhe kur do të fluturojë. Për aterrimin e një fillestari është i nevojshëm një livadh. Fluturuesve me vela ju mjafton një sipërfaqe që ka diametrin e një gjysmë metri. Nuk ekziston mënyra më e thjeshtë e fluturimit.

(përgatitur sipas tekstit të marr nga [https:// sh.m.wikipedia.org](https://sh.m.wikipedia.org))

1. Si quhet ndryshe paraglajdingu?

1 pikë

2. Nëse tema e dhënë në tabelë ndodhet në tekst, rretho PO, ndërsa nëse nuk është në tekst rretho JO.

TEMA	NË TEKST?	
Lloj i fluturimeve sportive	PO	JO
Siguria e pilotit	PO	JO
Lokalitet i përshtatshëm	PO	JO

1 pikë

3. Numëro pajisjet e nevojshme për paraglajding.

1 pikë

4. Për paraglajding nuk është i nevojshëm trajnimi i gjatë sistematik.

PO

JO

Rretho përgjigjen e saktë (PO ose JO) dhe argumentoje atë.

1 pikë

5. A) Çfarë është më me rëndësi për sigurinë e pilotit?

1 pikë

B) Argumentoje përgjigjen.

1 pikë

6. Paraglajdingu nuk është sport i shtrenjtë ajror. Gjeje dhe përshkruaje dëshminë nga teksti për këtë pohim.

1 pikë

7. Me cilin stil funksional është shkruar teksti?

1. administrativ
2. bisedimor
3. letrar

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

8. Teksti është:

1. administrativ
2. informativ
3. letrar

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

9. Përcakto klasën e fjalëve të nënvizuara në fjalitë:

Ai nuk e kuptoi sa vazhdoi. Vështroi sytë e mbyllur në ekstazë të vallëzonjësve. Pastaj pa shumë njerëz .

nuk _____ sa _____

të vallëzonjësve _____ shumë _____

1 pikë

10. Në fjali janë bërë dy gabime. Vëreji ato dhe fjalinë përshkruaje saktë.

Kur të pushoj era ne do të dëshiroi të fluturoi me paraglajder.

2 pikë

11. A) Rretho numrin para personazhit i cili nuk i përket grupit.

1. Tana
2. Adham-Uti
3. Zeneli
4. Vurko

1 pikë

B) Argumento përgjigjen.

1 pikë

Në bazë të fragmentit të dhënë, si dhe veprës në tërësi, zhvillo detyrat 12, 13 dhe 14.

Sot më vdiq mamaja. Apo ndoshta dje, nuk e di. Mora një telegram nga azili “Nëna vdiq. Varrimi nesër. Ngushëllime të sinqerta.” Kjo s’do të thotë asgjë. Ndoshta ka ndodhur dje.

Azili i pleqve ndodhet në Marengo, tetëdhjetë kilometra larg Algjerit. Do të marr autobusin e orës dy dhe do të jem aty pasdite. Kështu do të mund ta gdhij një natë e do të kthehem nesër mbrëma. I kërkova dy ditë leje pronarit dhe ai nuk mund të mos të m’i jepte për një arsye të tillë. Por m’u duk sikur nuk i pëlqeu. Madje dhe i thashë “S’është për fajin tim.” Nuk u përgjigj. Atëherë mendova se nuk duhet t’ia kisha thënë ato fjalë. Sidoqoftë, nuk kisha pse të kërkoja ndjesë. Ai bile duhet të më shprehte ngushëllime. Do ta bëj me siguri pasnesër, kur të më shohë në zi. Tani për tani duket sikur mamaja nuk ka vdekur. Ndërsa pas varrimit do të jetë një çështje e mbyllur dhe çdo gjë do të ketë marrë formë zyrtare.

12. A) Shkruaje titullin e veprës nga e cila është fragmenti i cituar.

1 pikë

B) Shkruaje emrin dhe mbiemrin e autorit të veprës.

1 pikë

13. A) Shkruaje emrin e personazhit i cili në fragment rrëfen për vdekjen e nënës.

1 pikë

B) Përshkruaje se si realizohet në vepër përditshmëria e personazhit kryesor.

2 pikë

14. Me cilën formë të shprehjes artistike është shkruar fragmenti?

1 pikë

15. Pranë emrit të personazhit letrar shkruaje titullin e veprës letrare në të cilën paraqitet dhe llojin letrar të cilit i përket vepra.

(vepra)

(lloji letrare)

Dr. Dhadha _____

Gjon Zaveri _____

2 pikë

16. Azili i pleqve ndodhet në Marengo, tetëdhjetë kilometra larg Algjerit

Fjalët e nënvizuara në fjali janë:

1. trajtë e shkurtër e përemrit dhe parafjalë
2. trajtë e shkurtër dhe ndajfolje
3. nyje e përparme dhe parafjalë
4. nyje e përparme dhe lidhëz

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

17. A) Rretho numrin para gjuhës e cila NUK BËN PJESË në familjen e gjuhëve të dhëna.

1. malazeze
2. bullgare
3. maqedonase
4. gjermane

1 pikë

B) Argumentoje përgjigjen.

1 pikë

18. A) Pranë titullit të veprës shkruaje emrin dhe mbiemrin e autorit të saj.

1. *Iliada* _____
2. *Kanconieri* _____
3. *Moti i madh* _____
4. *Ylli i Davidit* _____

1 pikë

B) Cila vepër nga detyra nën A i përket renesancës?

1 pikë

Lexo tekstin në vijim dhe përgjigju pyetjeve 19, 20, 21, 22 dhe 23.

Shqipëria dhe shqiptarët

O Shqipëri ku lindi Iskanderi
Këngë e rinis', fanar i t'urtëve!
Dhe Iskanderi tjetër, që i dërrmoi
Përherë armiqt' me Kordhn e tij kreshnike:
Shqipëri, lejomë të kthej syt' e mi
mbi ty, o nënë e rreptë burrash t'egër!
Kryqi po zbret, po ngrihen minaretë,
E zbeta hënëz ndrin nëpër lugina,
Mbi pyje me selvi n'agor të çdo qyteti.

Agimi lind; me të po çohen brigjet
E Shqipëris' së rreptë, shkëmb i Sulit,
Dhe larg të pindit çuka mjegull veshur;
Të lara përrenjsh të bardhë si dëbora
Me ngjyra mashkullore e kuqërreme,
Dhe ndërsa retë nisin të shpërndahen,
Spikasin tbanat e malësorëve;

Këtu bredh ujku, shqipja sqepin mbreh,
Zogj, bisha, njerëz t'egër zën' e duken,
Stuhitë rrotull tundin motin që mbaron.

Të rreptë bijt' e shqipes! Po vetitë
nuk u mungojnë; veç t'ishin më të arrira;
armiku ua pa kurrizin ndonjëherë?
Kush e duron si ata mundimin' e luftës?
Shkëmbinjt' e tyre s'janë më të patundur
Nga ata në çast rreziku dhe nevoje:
Ç'armiq për vdekje, po sa miq besnikë!
Kur besa e nderi i thret të derdhin gjakun,
Si trima turren ku t'i çojë i pari i tyre.

Haroldi i pa në kullë t'Ali Pashës
Tek niseshin në luftë e fitore;
Pastaj i pa kur vetë u ra në dorë,
Viktimë e dallgës s'egër n'udhë e sipër,
Kur rasti i bën të liqtë me të liq;
E pritën në shtëpi me të gjithë të mirat,
Gjind më pak t'egër presin ca më pak.

.....

„Çajld Harold” - Xhorxh Gordon Bajron

19. Fragmenti *Shqipëria dhe shqiptarët* mbështetet në motivin:

1. e ekzotizmit
2. e filozofisë
3. e dashurisë

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

20. Çfarë trajte të rrëfimit ka fragmenti i veçuar nga poema e *Çajld Haroldit*?

1 pikë

21. Dallo figurat stilistike.

1. O Shqipëri ku lindi Iskanderi _____ *1 pikë*
2. mbi ty, o nënë e rreptë burrash t'eger _____ *1 pikë*
3. Kryqi po zbret, po ngrihen minaretë _____ *1 pikë*

22. Shpjego domethënien e fjalëve të mëposhtme:

1. tbanat _____ *1 pikë*
2. fanar _____ *1 pikë*

23. Përshkruaj vargjet përkatëse nga poema me të cilat himnizohet:

A) Natyra shqiptare

1 pikë

B) Historia shqiptare

1 pikë

C) Virtytet shqiptare

1 pikë

24. Rretho numrin para personazhit i cili në veprën *Tartufi* karakterizohet nga naiviteti dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1. Elmira
2. Tartufi
3. Dorina
4. Oregoni

1 pikë

25. Nga shkrimtarët e dhënë veço përfaqësuesit më të rëndësishëm të letërsisë moderne të botës.

Uiliam Shekspir Sharl Bodëler L.N. Tolstoj Stefan Malarme A.P.Çehov

1 pikë

26. renesanca realizmi romantizmi

Përshkruaje emërtimin e epokës letrare elementet e të cilës e karakterizojnë melankolia dhe dhimbja botërore.

1 pikë

27. Lexo fragmentin nga vepra *Romeo dhe Zhuljeta* pastaj zhvillo detyrën në vazhdim.

Ajo atje nuk është drita e ditës,
Por është një meteor që e nxori dielli,
I cili do të bëhet pishtarmbajtës,
Të të ndriçojë rrugën e Mantovës.
Prandaj qëndro, se s'ke nevojë të ikësh.

A) Kush i thotë fjalët e dhëna:

1. Markuçi
2. Romeo
3. Zhuljeta

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

B) Fjalët i drejtohen:

1. Laurensit
2. Romeut
3. Zhulietës

Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1 pikë

28. Sipas rregullit për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit ndaji fjalët, siç kemi filluar.

ndriçim	ndri- çim
hekurudhë	
ekskursion	

1 pikë

29. Shkruaj trajtën përfaqësuese të foljeve të mëposhtme.

të kishte rënë _____

do të kisha ngrënë _____

1 pikë

30.

Janë ofruar dy tema për hartimin e esesë. Rrethoje numrin para temës që do ta zhvillosh. Eseja duhet të përmbajë 250 deri në 300 fjalë.

Hartoje atë si tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin. Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHEË FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi).

Gjatë hartimit të esesë kij kujdes për mënyrën e të shprehurit dhe për zbatimin e normave drejtshkrimore. Shkruaj lexueshëm.

1. Vlladikë Danillo dhe Hamleti personazhe tragjike

Udhëzime për shkrimin e esesë:

- Shkruaj cilës gjini/gjinive letrare i/u përkasin veprat *Hamleti* dhe *Kurora e maleve*.
- Përshkruaje:
 - vlladikën Danillo (tiparet e karakterit, raportin ndaj personazheve tjerë), Hamletin (tiparet e karakterit, raportin ndaj personazheve tjerë, fundin e tij).
- Në formë të përfundimit shpjego përse janë personazhe tragjike.

2. Dallimi në mes të brezave

Udhëzime për shkrimin e esesë:

- Jepe mendimin tënd për dallimin në mes të brezave.
- Shpjego përse bashkëmoshatarët tu shpesh “bien” në konflikte verbale me të moshuarit.
- Në Amerikë, që të kapërcehet dallimi ndërmjet brezave, është iniciuar programi eksperimental në të cilin janë kyçur universiteti dhe azilet e pleqve. Eksperimenti zgjat 19 muaj. Një studente 22 –vjeçare është shoqëruar me një njeri të moshës 87 vjeçare duke lozur letra dhe pas gjashtë muajve dallimi në mes të brezave është zhdukur. Jepe qëndrimin tënd për këtë eksperiment dhe mënyrën e kapërcimit të dallimit.
- A je i gatshëm/e gatshme për kompromis në mënyrë që moskuptimi në mes të brezave të tejkalohet, nëse do të ndodhte? Jepe shpjegimin.
- Në formë të përfundimit jepe propozimin tënd për tejkalimin e dallimit dhe keqkuptimin ndërmjet brezave.

25 pikë



2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

3

4

5

6

7

8

9

10

11